



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Nr. 6, datë 2.11.2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5627, DATË
18.11.2016 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE BRENDIA VENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 17 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 11, paragrafi i parë i pikës 6, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Autoriteti i licencimit, ose personi të cilit i delegohet kjo kompetencë, nëpërmjet një Komisioni Vlerësues të përcaktuar nga titullari, për zgjedh me konkurs të hapur, subjektin kandidat për të operuar në një linjë të rregullt ndërqytetëse udhëtarësh, në rastet kur:”.

Neni 2

Në nenin 13, pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me përmbajtjen si më poshtë:

3. Në rast se mbajtësi i një licence për linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës), tërhiqet nga operimi ose shpall falimentimin, apo autoriteti licencues ka marrë masën e heqjes së licencës, deri në përfundimin e procedurave të konkursit të përzgjedhjes/shpalljes fitues dhe licencimit të një subjekti tjetër për linjën përkatëse,

autoriteti licencues mund të lidhë një marrëveshje/kontratë të përkohshme me një subjekt të licencuar për shërbimin në linjat e rregullta të transportit të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës), me qëllim mbulimin dhe vazhdimin pa ndërprerje e këtij shërbimi.

Subjekti mund të ofrojë shërbimin edhe nëpërmjet mjeteve shtesë të marra me qira, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 16 të këtij udhëzimi. Në këtë rast autoriteti licencues duhet të pajisë subjektin me autorizim të përkohshëm, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi (Lidhja 1).

Afati i autorizimit vendoset nga autoriteti licencues, në përputhje me kushtet dhe afatet procedurale të pajisjes me autorizim, duke garantuar mbulimin dhe vazhdimin e plotë të shërbimit gjatë kësaj periudhe.

4. Në çdo rast të parashikuar në pikën 3, të këtij neni, subjekti i cili do të tërhiqet, ka shpallur falimentimin, apo i hiqet licenca ka detyrimin të mbulojë me shërbim linjën deri në 1 (një) muaj pas njoftimit për tërheqje, ose fillimit të procedurave të falimentit, apo marrjes së vendimit për heqjen e licencës, nëse do kërkohet nga autoriteti licencues”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në “Fletore Zyrtare”.

MINISTRI

Belinda Balluku

Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 201, Datë. 18/11/2020